



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 par. 4 dhe 5 i Rregullores MF - Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare në Organizatat Buxhetore si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunës merr

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR PRANIMIN E PASURISË JO FINANCIARE TË KOMUNËS

Neni 1

Përbërja e Komisionit

Për pranimin e pasurisë jofinanciare të Komunës formoj Komisionin në këtë përbërje:

- 1.Isak Shala , Kryesues
- 2.Ymer Bikliqi, anëtar
- 3.Floranda Zeqiri, anëtare

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni në pajtim me Rregulloren MF -Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare në Organizatat Buxhetore, pranon pasurinë jofinanciare të Komunës dhe gjatë pranimit ka për detyrë si vijon :

- 1.Të verifikojë sasinë e porositur, cilësinë, llojin dhe vlerën e pasurisë jofinanciare në përputhshmëri me kontratën për urdhërblenjen.
2. Komisioni nuk duhet të pranojë pasurinë jofinanciare e cila nuk është në përputhje me kontratën dhe urdhërblenjen (mënyra e amabalazhimit, cilësisë llojllojshmërisë, plotësisë dhe marka e prodhimit).
3. Komisioni gjatë pranimit të pasurisë jofinanciare harton procesverbal dhe në rastet e mospranimit të pasurisë jofinanciare shënon edhe arsyetimin e mospranimit.
4. Mandati i këtij Komisioni zgjat deri më 31.12.2017.
5. Komisioni ka për detyrë që për çdo tre mujor ti paraqes informatë me shkrim Kryetarit të Komunës për zbatimin në praktikë të këtyre detyrave .

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës ndërsa me kopjen e këtij Vendimi të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 404 -1911
Lipjan, më 18.01.2017

